



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.608/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Podujevë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike në objekte fetare për qëllime elektorale të subjektit politik LDK, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.10.2021, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.608/2021 e datës 06.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Podujevë, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Podujevë, t'i shqiptohet gjobë për shkak të mbajtjes së tubimeve publike në objekte fetare, për Zgjedhjet Lokale 2021 që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 06.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Podujevë, në të cilën pretendon se me datë 05 Tetor 2021 rreth orës 13:00, aktivistet e këtij të Qendrës në Podujevë, kanë vërejtur se aktivistet e subjektit politik LDK, me mbështetësit e saj në xhaminë e vjetër të fshatit Majac në komunën e Podujevës kanë mbajtur tubim publik për qëllime elektorale, ku mbështetësit e këtij subjekti politik fotot nga tubimi politik i lartcekur i kane shpërndarë në rrjetin social Facebook

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 4.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013 Fushata Zgjedhore dhe Njoftimi i Ngjarjeve Politike.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2021, subjekti politik LDK e kundërshton pretendimin e subjektit politik LVV se objekti në fjalë është objekt fetar- xhami, pasi që nga fotot e ofruara nuk mund të verifikohen 100%, ngase xhamitë siç dihet kanë minaren, nuk lejohen të vendosen karrige apo elemente të ngjashme, ngase ritualet fetare kryhen në hapësirë të rrafshët dhe nuk vendosen zakonisht asgjë mbi to andaj e njëjta i propozon PZAP-it që ankesën e tillë ta refuzoj.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës Anr.608/2021, të datës 06.10.2021, të njëjtën ia kthej në plotësim subjektit politik (LVV) duke i kërkuar që të bëj plotësimin e saj deri me datën 09.10.2021, në ora 09.00, duke i kërkuar që në mënyrë të detajuar të specifikohet me dëshmi shtesë se në çfarë objekti fetar është mbajtur ky tubim në kohën kur ka ndodhur shkelja, dhe të ofroj fotografi (me ngjyra) më të qarta dhe më të detajuara lidhur me tubimin në fjalë.

Parashtruesi ka bërë plotësimin e ankesës me datën 09.10.2021, në të cilën ka theksuar se kjo fotografi është postuar në rrjetin social Facebook me datën 05.10.2021 në faqen zyrtare të kandidatit për kryetar nga radhët e subjektit politik LDK, z. Ekrem Hyseni. Më tutje thekson se pamjet që shihen në fotografinë e postuar nga administratorët e faqes së kandidatit Ekrem Hyseni i përkasin ambienteve të brendshme të xhamisë së fshatit Majac rruga “Shahin Krasniqi” Komuna e Podujevës, ndërsa kandidati i subjektit politik LDK pasi që e kishte postuar fotografinë të cilën ja kemi bashkangjitur ankesës për ti ikur përgjegjësisë për shkelje të rregullave zgjedhore të njëjtën fotografi e kishte fshirë nga rrjeti social facebook dhe e kishte ripostuar prapë të njëjtën duke e edituar dhe modifikuar me qëllim që të mbulohen pjesët e një objekti kulti-xhami. Përgjigjes si dëshmi i ka bashkangjitur disa fotografi (me ngjyra) të printuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, si dhe nga ato të cilat i ka bashkangjitur plotësimin të ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik LDK, është përdorur ndonjë objekt fetar për fushatë zgjedhore.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehen vetëm se janë realizuar disa tubime të subjektit politik LDK, në të cilin tubime kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se ndonjë tubim është mbajtur në objekt fetar gjegjësisht në xhamin e fshatit ashtu siç pretendohet nga pala ankuuese, pasi që nga të gjitha fotografit e dorëzuara si provë nuk mund të vërehet asnjë shenjë –simbole fetare apo ndonjë element i objektit fetar-xhamisë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.608/2021 më datën 09.10.2021



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform me nenin 118 par. 4 të LZP-së.*